



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Metodika mbi Statistikat Monetare dhe Financiare

V e r z i o n i 2 . 0

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA

CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Metodika mbi Statistikat Monetare dhe Financiare

BOTUES

© Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
33 Garibaldi, Prishtinë 10000
Tel: ++381 38 222 243
Fax: ++381 38 243 763

FAQJA E INTERNETIT

www.bqk-kos.org

ADRESA ELEKTRONIKE

statistics@bqk-kos.org

PËRMBAJTJA

1. Baza ligjore	5
2. Njësitë institucionale	5
3. Rezidenca	6
4. Sektorizimi i njësive institucionale	7
4.1. Korporatat financiare	7
4.2. Korporatat jofinanciare	10
4.3. Qeveria e përgjithshme	10
4.4. Ekonomitë familjare	10
4.5. Oorganizatat jo me qëllim fitimi që i shërbejnë ekonomive familjare	10
5. Instrumentet financiare	10
6. Pasqyra e korporatave financiare	12
7. Normat e interesit	13
8. Burimi i të dhënave	14
9. Periodiciteti	15

1. Baza ligjore

Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-074, Banka Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) është përgjegjëse për përpilimin dhe publikimin e statistikave monetare dhe financiare. Në kuadër të statistikave monetare dhe financiare përfshihen statistikave të BQK-së, korporatave tjera depozituese, kompanive të sigurimit, fondeve pensionale, ndërmjetësve tjerë financiar, dhe ndihmësve financiar. Statistikat monetare dhe financiare përpilohen dhe publikohen bazuar në standardet ndërkombëtare, respektivisht bazuar në Manualin e Statistikave Monetare dhe Financiare (FMN 2000), Udhëzuesin e Përpilimit të Statistikave Monetare dhe Financiare (FMN 2008), Manualin mbi Normat e Interesit të Bankave Komerciale (ECB 2003), Sistemin i Llogarive Kombëtare (edicionet SNA 93 dhe SNA 2008), dhe Sistemin Evropian të Llogarive Kombëtare dhe Regjionale (ESA 95).

2. Njësitë institucionale

Ekonomia përbëhet nga njësitë institucionale, që mund të definojnë si entitete ekonomike që posedojnë asete, obligime dhe angazhohen në aktivitetet ekonomike dhe në transaksionet me entitetet tjera. Njësitë institucionale, si mbajtës të aseteve dhe obligimeve financiare, përbëjnë shtyllën kryesore të statistikave monetare dhe financiare dhe mbajnë asete financiare në formë të parasë së gatshme, depozitave, letrave me vlerë, investimeve në fondet e caktuara, etj. Katër karakteristikat kryesore të njësive institucionale janë me sa vijon:

1. Mund të përvetësojnë asete në emër të tyre;
2. Kanë të drejtë që të marrin vendime ekonomike dhe të angazhohen në aktivitetet ekonomike;
3. Kanë të drejtë që të kenë obligime në emër të tyre;
4. Kanë sistemin e llogarive apo mund të përpilojnë ato.

Njësitë institucionale ndahen në *ekonomi familjare* dhe *entitete ligjore*.

Ekonomitë familjare përbëhen nga një apo më shumë persona që ndajnë të njëjta kushte jetese, që bashkojnë një pjesë apo të gjitha të hyrat dhe të cilët konsumojnë mallrat dhe shërbimet (kryesisht ato shtëpiake) në mënyrë kolektive. Pjesa më e madhe e vendimeve mbi shpenzimet, posaçërisht të vendimeve që kanë të bëjnë me konsumin dhe shpenzimet tjera shtëpiake, mund të merren në mënyrë të përbashkët në të mirë të ekonomisë familjare. Aktiviteti i ekonomive familjare që ka të bëjë me prodhimin dhe shitjen e mallrave dhe shërbimeve trajtohet si pjesë integrale e ekonomive familjare nëse madhësia e aktivitetit nuk lejon trajtimin si kuazi-korporatë.

Entitetet ligjore përbëhet nga ato njësi institucionale që janë të angazhuara në aktivitetet ekonomike në emër të tyre. Këto entitete janë përgjegjëse për vendimet ekonomike që marrin. Ekzistojnë katër kategori kryesore të entiteteve ligjore, dhe atë:

1. *Korporatat* janë entitete ligjore të krijuara me qëllim prodhimin të mallrave dhe shërbimeve për treg. Ato mund të jenë të organizuara në formë të korporatave me

- një apo më shumë aksionar ku kontrolli ushtrohet përmes fuqisë votuese. Kontrolli në korporata mund të jetë i plotë (efektiv) dhe i pjeshëm (joefektiv). Kontrolli efektiv definohet kur një aksionar ka në dispozicion më shumë se 50% të aksioneve në korporatë (më shumë se gjysmën e fuqisë votuese). Karakteristikat kryesore të korporatave janë me sa vijon: (i) ekzistimi i tyre është i njohur në mënyrë të pavarur si njësi e veçantë, (ii) ato janë krijuar me qëllim të prodhimit të të mirave materiale për treg, (iii) ato janë përgjegjëse dhe japin llogari për aktivitetet e tyre, (iv) kontrolli ushtrohet nga aksionari apo aksionarët.
2. *Kuazi-korporatat* janë korporata të painkorporuara që funksionojnë sikurse të jenë korporata dhe kanë sistemin e llogarive. Për qëllime të sektorizimit dhe nënsektorizimit, ato trajtohen si njësi institucionale të ndara nga njësitë që i përkasin. Kuazi korporatat përfshijnë (i) ndërmarrjet shtetërore të painkorporuara të angazhuara në aktivitetet e prodhimit dhe që operojnë në mënyrë që ngjashme me korporatat publike jofinanciare, (ii) njësitë e painkorporuara të menaxhuara nga ekonomitë familjare të angazhuara në aktivitetet e prodhimit duke operuar sikurse të ishin korporata private, dhe (iii) njësitë e painkorporuara në pronësi të pjesshme apo të plotë të jorezidentëve.
 3. *Njësitë qeveritare* janë entitete ligjore të themeluara bazuar në proceset politike dhe kanë autoritet legjislativ, juridik, dhe ekzekutiv. Aktiviteti i këtyre njësive institucionale financohet përmes të hyrave që mund të jenë të hyra tatimore dhe jo tatimore. Funkzioni kryesor i tyre është (i) ofrimi i mallrave dhe shërbimeve të gjithë komunitetit duke u angazhuar në aktivitete jo tregtare (jo prodhuese), dhe (ii) rishpërndarja e të hyrave dhe të mirave materiale.
 4. *Organizatat jo me qëllim fitimi që i shërbejnë ekonomive familjare (OJSHEF)* janë entitete ligjore të krijuara me qëllim të ofrimit të mallrave dhe shërbimeve por që qëllimi i tyre nuk është fitimi. OJSHEF-të janë të ndara nga njësitë institucionale që i kanë krijuar ato.

3. Rezidenca


Ndarja në mes të njësive institucionale rezidente dhe jo rezidente është çështje kyçe në statistikën monetare dhe financiare. Tek definimi i rezidencës, dy parime janë me rëndësi, dhe atë: teritori ekonomik dhe qendra e interesit ekonomik. Teritori ekonomik i një vendi përbëhet nga teritori gjeografik i administruar nga qeveria brenda të cilit personat, mallrat dhe kapitali lëvizin lirshëm dhe përfshin hapësirën ajrore, ujore, tokësore, zyrat diplomatike janë vendit, bazat ushtarake jashtë vendit, etj. Një njësi institucionale është rezidente në një shtet nëse ka interes ekonomik në atë shtet, respektivisht ekziston aktiviteti i prodhimit në shkallë të rëndësishme.¹

¹ Shkallë të rëndësishme do të thotë që njësia institucionale (në këtë rast korporata) ka së paku një vijë të aktivitetit (prodhimit apo shërbimeve) në atë vend dhe planifikon që këtë aktivitet ta vazhdojë më shumë se një vit.

4. Sektorizimi i njësive institucionale

Sektorizimi i njësive institucionale është element kyç lidhur me përpilimin e statistikave monetare dhe financiare. Skema e sektorizimit të njësive institucionale është paraqitur me sa vijon.

Skema 1. Sektorizimi i njësive institucionale



Burimi: SNA 2008

4.1. Korporatat financiare

Sektori i korporatave financiare përbëhet nga të gjitha korporatat apo kuazi-korporatat rezidente të angazhuara në ndërmjetësimin financiar apo aktivitetet financiare mbështetëse që janë ngushtë të lidhura me ndërmjetësimin financiar. Korporatat financiare ndahen në korporata depozituese (banka qendrore dhe korporatat tjera

depozituese) dhe në korporata tjera financiare (ndërmjetësit tjerë financiar, kompanitë e sigurimit, fondet pensionale dhe ndihmësit financiar). Në vazhdim është paraqitur struktura e korporatave financiare në Kosovë.

Tabela 2. Korporatat financiare në Kosovë

Nësektorët	Emri i institucionit
Banka qendrore	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Korporatat tjera depozituese	Banka për Biznes, Banka Ekonomike, Banka Kombëtare Tregtare, Komercijalna Banka, NLB Prishtina, ProCredit Bank, Raiffeisen Bank, Türk Ekonomi Bankasi.
Kompanitë e sigurimit	Croatia Osiguranje, Dardania, Dukagjini, Elsig, Insig, Kosova e Re, Sigal Drini, Sigkos, Sigma, Siguria.
Fondet pensionale	Fondi Slloveno Kosovar, Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës.
Ndërmjetësit tjerë financiar	Agency for Finance in Kosovo, Agro Business Development Unit, Atlantic Capital Partners, Besëlidhja, Ce.L.I.M., Cordaid, Crimson, Factor Leasing Kosovo, Finca, KGMAMF - Grameen Trust, Kosinvest World Vision, Kosova Aid and Development, Kosovo Enterprise Program, Kreditimi Rural i Kosovës, Lesna Mështekna, Perspektiva 4, Raiffeisen Leasing Kosovo, Start.
Ndihmësit financiar	Agimi, Agoni, Beni, D.M.TH., E-Bani, Euro, Euro Cufa, Euro Eki, Euro Exchange, Fondi Slloveno Kosovar, Gipa, Hamza, Indriti, KLM Entrprises, Mena, Monedha, NBS, Pëllumbi, Prizreni, ProCredit Bank Western Union, PTK, Raiffeisen Bank Western Union, Te Gazi, Unioni Financiar Prishtina, Valuta, Veli, Vllesa, Xeni, Ximi.

Banka qendrore është institucioni financiar kryesor në një vend që ushtron kontrollin financiar në kuadër të sistemit financiar. Banka qendrore kryen aktivitete si emetimi i parasë, menaxhimi i rezervave ndërkombëtare, transaksionet me FMN, kreditimi i ekonomisë, ofrimi i kredisë bankave komerciale, etj. Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, funksionin e bankës qendrore e kryen Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. Objektivat kryesore bazuar në Ligjin mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, janë paraqitur më poshtë:

“Neni 5

Objektivat kryesore

Objektivat kryesore të BQK-së janë:

- a) *Të nxisë sigurinë, aftësinë e pagimit dhe funksionimin efikas të sistemit financiar stabil të bazuar në treg, duke inkurajuar daljen e instrumenteve financiare të sigurta në treg, dhe*
- b) *Pa paragjykuar këtë, të mbështesë politikat e përgjithshme të ekonomisë në Kosovë, me synim të kontribuimit në ndarjen efikase të resurseve në pajtim me parimin e ekonomisë së tregut të hapur.”*

Korporatat tjera depozituese përbëhen nga korporatat dhe kuazi korporatat financiare rezidente (përveç bankës qendrore) që janë të angazhuara në ndërmjetësimin financiar dhe që obligimet e tyre janë pjesë e parasë së gjerë. Korporatat tjera depozituese përbëhen nga bankat komerciale dhe korporata tjera që mbajnë depozita. Në rastin e Kosovës, korporatat tjera depozituese janë bankat komerciale. Që nga qershori 2004 ekziston ndryshim metodik lidhur me përpilimin dhe publikimin e statistikave të këtyre korporatave në kontekst të sektorëve, instrumenteve dhe afatizimeve. Kjo konsiston me fillimin e zbatimit të projekteve statistikore: Raporti Statistikor Bankar dhe Raporti mbi Normat e Kamatës. Për më shumë, këto projekte statistikore janë avancuar vazhdimisht në kontekst të vëllimit të statistikave, sektorëve, instrumenteve dhe afatizimeve.²

Kompanitë e sigurimit përbëhen nga kompanitë ku funksioni kryesor i të cilave është sigurimi jetësor, aksidental, sëmundja, zjarri si dhe forma të tjera të sigurimit për njësitë institucionale apo grupet e njësive. Në rastin e Kosovës, kompanitë e sigurimit janë të licencuara për sigurimin jetësor dhe jo jetësor (psh. sigurimi i automjeteve, sigurimi ndaj zjarrit, etj). Statistikat mbi kompanitë e sigurimeve që operojnë në Kosovë përpilohen dhe publikohen në bazë tremujore, përfshirë bilancin e gjendjes, bilancin e suksesit, etj. në përputhje me standardet ndërkombëtare statistikore.

Fondet Pensionale janë themeluar për qëllime të sigurimit të beneficioneve pensionale për grupet specifike (kontribuuesit) të punëtorëve. Fondet pensionale kanë mjetet dhe obligimet e veta ndërsa bëjnë transaksione ekonomike në emër dhe përgjegjësi të veten. Në rastin e Kosovës, skema e fondeve pensionale përbëhet nga këto tri shtylla:

- a) Pensioni bazë i obliguar, që në fakt paraqet sigurim social, paguhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Buxheti i Kosovës të gjithë personave në moshë 65 vjeçare e mbi;
- b) Kontributet individuale të pensioneve përbëhen nga mjetet e paguara nga punëdhënësi (5% pagës së punëtorit) dhe punëtori (5% e pagës) dhe menaxhohen nga Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës;
- c) Kontributet plotësuese të pensioneve, të paguara për punëtorët që mund të alokohen nga punëtori në të gjitha fondet pensionale të licencuara që operojnë në Kosovë.

Në rastin e Kosovës, pensioni bazë i obliguar (pika “a”) është pjesë e sektorit fiskal, ndërsa kontributet individuale të pensioneve (pika “b”) dhe kontributet plotësuese të pensioneve (pika “c”) janë pjesë e sektorit financiar. Në rastin e Kosovës, statistikat mbi fondet pensionale përpilohen dhe publikohen në bazë tremujore, konform standardeve ndërkombëtare statistikore.

Ndërmjetësit tjerë financiar përbëhen nga të gjitha korporatat rezidente të angazhuara në ndërmjetësimin financiar përveç korporatave depozituese, korporatave të sigurimit dhe fondeve pensionale. Në Kosovë, ndërmjetësi tjerë financiar përbëhen nga institucionet mikrofinanciare. Këto institucione financiare janë të angazhuara në huadhënie në shuma më të vogla në krahasim me ato të bankave, kryesisht në vendet rurale, ndërsa financimi sigurohet kryesisht nga donatorët. Që nga fillimi i publikimit të këtyre statistikave (qershor 2004) e deri në dhjetor të vitit 2007, bilancet e gjendjes janë përpiluar bazuar në llogaritë vjetore të institucioneve mikrofinanciare të raportuara në BQK. Mirëpo, duke

² Deri më tani, Raporti Bankar Statistikor dhe Raporti mbi Normat e Kamatës janë ndryshuar katër herë duke arritur në versionet 2.0 që kanë filluar të implementohen që nga janari 2010.

filluar nga viti 2008, institucionet mikrofinanciare në bazë tremujore raportojnë BQK bilancet e gjendjes dhe të suksesit dhe statistika të tjera përkatëse.

Ndihmësit financiar kanë të bëjnë me institucionet financiare që nuk lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë në ndërmjetësimin financiar e që mund të jenë këmbimoret, brokerët, agjentët e ndryshëm, etj. Në Kosovë ky nënsektor përbëhet këmbimoret dhe agjencitë për transferin e parave. Në kuadër të ndihmësve financiar, të dhënat merren bazuar në mostrën që përfshinë më rreth 95% të këtyre institucioneve bazuar në kontekst të aseteve të tyre.

4.2. Korporatat jofinanciare

Korporatat jofinanciare janë korporatat ku aktiviteti kryesor i tyre është prodhimi i mallrave dhe shërbimeve për treg, dhe si të tilla nuk janë të angazhuara në ndërmjetësimin financiar. Ndarja kryesore e korporatave jofinanciare është në korporata publike jofinanciare dhe korporata tjera jofinanciare. Në kuadër të korporatave publike jofinanciare përfshihen ato korporata që janë të kontrolluara nga qeveria ku funksioni kryesor i tyre është prodhimi i mallrave dhe shërbimeve për treg. Në rastin e Kosovës, korporatat publike jofinanciare janë Posta dhe Telekom i Kosovës, Korporata Elektroenergjetike e Kosovës, etj. Ndërsa në kuadër të korporatave tjera jo financiare hyjnë të gjitha korporatat private jofinanciare që operojnë në Kosovë.

4.3. Qeveria e përgjithshme

Qeveria e përgjithshme përbën entitetin ligjor që ka funksion unik në një shtet, që është themeluar nga proceset politike, dhe që ka fuqi legjislative, juridike dhe ekzekutive. Në rastin e Kosovës, qeveria përbëhet nga qeveria qendrore dhe qeveritë lokale. Në kuadër të qeverisë qendrore përfshihen Kuvendi i Kosovës, ministritë, administrata tatimore, etj., ndërsa në kuadër të qeverisë lokale përfshihen komunat.

4.4. Ekonomitë familjare

Ekonomitë familjare përbëhen nga një apo më shumë persona që bashkojnë të hyrat dhe ku vendimet merren në mënyrë të përbashkët në të mirë të ekonomisë familjare. Në raste të caktuara, bankat komerciale që operojnë në Kosovë, ndërmarrjet e painkorporuara i klasifikojnë në kuadër të entiteteve ligjore që mund të rezultojë në sektorizim jo adekuat.

4.5. Organizatat jo me qëllim fitimi që i shërbejnë ekonomive familjare

OJSHEF-të janë entitete ligjore ku qëllimi i tyre nuk është fitimi. Në rastin e Kosovës, në kuadër të OJSHEF hyjnë institucionet fetare, bamirësie, etj.

5. Instrumentet financiare

Instrumentat financiare përbëjnë një shumëllojshmëri të kontratave financiare në mes të njësisive institucionale dhe ndahen në asete financiare (paraja e gatshme, depozitat, letrat

me vlerë, etj) dhe instrumente tjera financiare. Asetet financiare janë asetet nga të cilat njësitë institucionale kanë përfitime si pasojë e mbajtjes apo përdorimit të tyre për një kohë të caktuar. Pjesa dërmuese e asetëve financiare janë kërkesa financiare që dalin nga marrëdhëniet kontraktuale në rastet kur një njësi institucionale ofron fonde njësisë tjetër institucionale. Klasifikimi i instrumenteve financiare bazohet në dy kritere kryesore (i) likuiditetin e asetëve, që bazohet në parimet e negociimit, transferimit, dhe konvertimit, dhe (ii) karakteristikat ligjore që rregullojnë marrëdhëniet debitorë/kreditorë.

Ari Monetar është aset financiar që përbëhet nga ari (monetar) që mbahet nga bankat qendrore (ose qeveritë). Ari monetar është pjesë e rezervave ndërkombëtare. Të Drejtat Speciale të Tirazhit (DST) që po ashtu janë pjesë e rezervave ndërkombëtare, janë të krijuara nga FMN-ja dhe të alokuara vendeve anëtare që të plotësojnë rezervat e tyre ndërkombëtare. Vendeve të cilave FMN-ja iu alokon DST-së nuk kanë obligim ndaj FMN-së që të paguajnë DST-të e alokuara. DST-të mbahen vetëm nga vendet anëtare të FMN-së. Që nga qershori i vitit 2009, Republika e Kosovës është anëtare e Fondit Monetar Ndërkombëtar. Vlera e DST-ve të alokuara është 59 milion DST që i jep të drejtën e 840 votave, ose 0.04 përqind të fuqisë votuese në FMN.

Paraja e gatshme përfshinë kartëmonedhat dhe monedhat me vlerë nominale fikse. Ndarja kryesore e parasë së gatshme ka të bëjë me paranë vendore (që emetohet nga banka qendrore e vendit përkatës) dhe në paranë e huaj (e emetuar nga banka qendrore e vendit tjetër). Në rastin e Kosovës, BQK-ja nuk emeton para të gatshme, mirëpo që përdor valutën euro zi valutë zyrtare dhe si mjet pagese.

Depozitat përfshijnë depozitat e transferueshme dhe depozitat tjera. Depozitat e transferueshme përfshijnë depozitat që janë të arkëtueshme në të parë. Depozitat tjera përfshijnë të gjitha kërkesat, ndryshe nga depozitat e transferueshme, mbi bankën qendrore, institucionet tjera depozituese, etj. Format tipike të depozitave tjera (jo të transferueshme) janë depozitat e kursimeve dhe depozitat e afatizuara.

Letrat me vlerë përveç aksioneve përfshijnë letrat me vlerë (bills dhe bonds), certifikatat e depozitave, letrën komerciale të tregtuar në tregjet financiare. Këto lloje të asetëve financiare nuk shfaqen ende në anën e obligimeve të sektorit financiar në Kosovë.

Kreditë përfshijnë të gjitha asetet financiare që janë krijuar kur kreditorët japin fonde direkt te borxhlinjtë dhe mund të jenë me afate të ndryshme dhe sektorë të ndryshëm, si ekonomitë familjare dhe korporatat jofinanciare, etj.

Kapitali aksionar përfshin kapitalin aksionar, fitimin e mbajtur, fitimin/humbjen gjatë periudhës raportuese, si dhe rezervat e përgjithshme apo të veçanta.

Rezervat teknike të sigurimit janë nën-ndarë në (i) kapitalin neto të ekonomive familjare në rezervat e sigurimit të jetës dhe fondet pensionale, (ii) parapagimet e premive dhe rezervat përkundrejt kërkesave të papaguara që duhet të paguhen në fillim të periudhës të mbuluar me sigurim, dhe (iii) rezervat kundrejt kërkesave të papaguara.

Llogaritë tjera të arkëtueshme/pagueshme, kryesisht përbëhen nga llogaritë e pranueshme dhe të pagueshme. Kategoritë kryesore në kuadër të llogarive të arkëtueshme/pagueshme janë: dividenda e arkëtueshme/pagueshme, llogaritë e barazimit (angl. settlement account), etj.

6. Pasqyra e korporatave financiare

Pasqyrat e korporatave financiare paraqesin pozicionin financiar të sektorit financiar ndaj sektorëve tjerë të ekonomisë (sektorit fiskal, real dhe i jashtëm). Pasi që tek pasqyrat e korporatave financiare zbatohet qasja sektoriale, definimi i korresponduesve rrespektivisht palës tjetër në transaksion (counterpart) ka rëndësi kyçe. Pala tjetër në transaksion është definuar si një sektor institucional ku mbajtësi i instrumentit ka kërkesë. Në rast të depozitave të afatizuara nga korporata jofinanciare me bankën komerciale, korporata ka kërkesë mbi bankën komerciale. Në rast të letrës me vlerë, mbajtësi ka kërkesë te emetuesi i letrës me vlerë (për shembull korporata që emeton aksione), pa marrë parasysh nga kush ishte blerë. Pasqyra e sektorit financiar dhe nënsektorëve që aplikohet në rastin e Kosovës, është prezantuar si në vijim.

Skema 2. Pasqyra e korporatave financiare

Asetet e jashtme neto (+/-)
Kërkesat ndaj jorezidentëve
Ndarja sipas instrumentit
Obligimet ndaj jorezidentëve
Ndarja sipas instrumentit
Kërkesat vendore
Kërkesat neto ndaj sektorin e qeverisë
Ndarja sipas instrumentit
Kërkesat në nënsektorët tjerë
Ndarja sipas instrumentit
Obligimet vendore
Obligimet ndaj nënsektorëve
Ndarja sipas instrumentit
Kapital aksionar dhe të ngjashme
Zëra të tjerë (+/-), përfshirë konsolidimin

Çështje me rëndësi tek pasqyrat e korporatave financiare përbëjnë klasifikimi i kërkesave dhe obligimeve sipas asaj se çka përbën kërkesat/obligimet ndaj sektorëve rezidentë si dhe çka janë kërkesat/obligimet ndaj sektorit jorezidentë.


Kërkesat/obligimet ndaj jorezidentëve përbëjnë kërkesat/obligimet e korporatave specifike (p.sh. korporatave tjera depozituese) ndaj jorezidentëve. Këto kërkesa/obligime mund të jenë në formë të instrumenteve të ndryshme si në formë të: parasë së gatshme, depozitave, kredive, letrave me vlerë, etj. Definimi sektorial i kërkesave/obligimeve duhet të bëhet në nivel të pasqyrës së bankës qendrore, korporatave tjera depozituese dhe korporatave tjera financiare.

Kërkesat/obligimet ndaj sektorëve rezidentë kanë natyrë të njëjtë sikurse kërkesat/obligimet ndaj jorezidentëve mirëpo kanë të bëjnë vetëm me sektorët vendor (p.sh. kërkesat/obligimet ndaj sektorit qeveritar, ndaj korporatave jofinanciare, ekonomive familjare, si dhe ndaj OJSHEF-ve).

Është me rëndësi të ceket se me rastin e përpilimit të pasqyrave financiare, kërkesat/obligimet ndaj sektorit të jashtëm (jorezident) si dhe ndaj sektorit qeveritar, paraqiten në bazë neto, pra, zbriten kërkesat me obligimet për sektorin e caktuar. Ndërsa kërkesat/obligimet ndaj sektorëve tjerë, si ndaj korporatave jofinanciare, ekonomive familjare si dhe ndaj OJSHEF-ve, paraqiten në bazë bruto.

Konsolidimi paraqet eliminimin (zbritjen) e zërave të përbashkët në mes të nënsektorëve kur paraqesim gjendjen e konsoliduar të nënsektorit përkatës. Nëse paraqesim gjendjen e konsoliduar të korporatave tjera depozituese, atëherë do të thotë se të gjitha zërat bilancor që kanë pasur këto korporata ndërmjet veti janë zbritur. P.sh. banka A ka marrë kredi nga banka B në vlerë 100.000 euro, atëherë me rastin e paraqitjes së gjendjes së konsoliduar kjo vlerë duhet të zbritet. Kjo nënkupton zbritjen e obligimeve të bankës A me kërkesat e bankës B. Konsolidimi në rastin e Kosovës, bëhet bazuar në si në skemën e shënuar më poshtë.

Skema 3. Sistemi i konsolidimit të korporatave financiare



7. Normat e interesit

Statistikat mbi normat e interesit kanë të bëjnë me statistikën e normave të interesit në depozita dhe kredi të korporatave tjera depozituese. Korporatat tjera depozituese në rastin e Kosovës janë bankat komerciale. Në kuadër të depozitave raportohen normat e interesit në llogaritë rrjedhëse, depozitat e afatizuar dhe depozitat e kursimeve, ndërsa kreditë raportohen të ndara sipas qëllimit (kredi investuese, kredi joinvestuese, kredi konsumuese, mbitërheqje, etj). Normat e interesit raportohen vetëm për kontratat e reja. Normat e interesit raportohen vetëm për korporatat jofinanciare dhe ekonomitë familjare.

Statistikat e normave të interesit përpilohen bazuar në projektin statistikor Raporti mbi Normat e Kamatës. Që nga fillimi i zbatimit të Raportit mbi Normat e Kamatës, qershor 2004, me qëllim të avancimit të vazhdueshëm të këtij projekti statistikor, deri më tani janë

përpiluar katër versione, që implikojnë edhe ndryshime metodike. Për më shumë, që nga janari 2008 normat e interesit në kredi përfshijnë edhe shpenzimet administrative që paguajnë kredimarrësit me rastin e marrjes së kredive. Po ashtu, që nga fillimi i vitit 2010, me rastin e llogaritjes së normës së ponderuar të interesit në kredi, nuk përfshihen kreditë me kushte favorizuese (p.sh. kreditë e mbuluara me kesh, etj).

Normat e interesit llogariten sipas normës së kontraktuar të vjetorizuar. (angl. Annual Agreed Rate). Ekuacioni i mëposhtëm paraqet formulën për vjetorizimin e normës së kontraktuar

$$AAR = \left(1 + \frac{AG}{n}\right)^n - 1$$

ku AAR është norma e kontraktuar e vjetorizuar, AG është norma në bazën vjetore e pajtuar në mes të palëve, dhe n është numri i periudhave të kapitalizimit brenda vitit. Si $n=1$ kur interesi paguhet një herë në vit, $n=2$ kur interesi paguhet çdo gjashtë muaj, $n=4$ kur interesi paguhet çdo tre muaj, dhe $n=12$ kur interesi paguhet çdo muaj.

Norma e interesit e raportuar duhet të reflektoj se çfarë banka paguan në depozita dhe çfarë banka merr nga kreditë. Në rastet kur banka merr subvencione nga një palë e tretë (psh. një donator) për kreditë e dhëna, këto subvencione konsiderohen si pjesë e normës së interesit. Për shembull, nëse një klient paguan 6% normë vjetore për një kredi, ku norma 10% është caktuar nga banka për këtë kredi, por një palë e tretë paguan 4% interesin për këtë kredi, atëherë duhet të raportohet norma prej 10%. Në mënyrë analoge, në rast të një depozitimi merret parasysh se çka banka paguan por jo atë që klienti merr nga pagesa e interesit. Për shembull, nëse një klient i bankës merr 5% normë vjetore nga një depozit në bankë, ku 3% paguhet nga banka ndërsa pjesa tjetër 2% si subvencion nga një palë e tretë e cila transferohet te klienti përmes bankës, atëherë duhet të raportohet norma prej 3%.

Kriteret e publikimit të normave të interesit janë definuar me sa vijon:

- 1) Minimumi tri observime (variabla) për secilin produkt;
- 2) Devijimi standard për secilin produkt nuk duhet të kaloj koeficientin prej 0.6 për depozita dhe kredi;
- 3) Nëse kriteri i dytë nuk është plotësuar, atëherë merret parasysh pjesëmarrja e bankës individuale në produktin e caktuar, me kusht që kjo pjesëmarrje nuk i kalon 30% të gjithë shumën e depozitave apo kredive për periudhën përkatëse.

8. Burimi i të dhënave

Burim i të dhënave mbi përpilimin e statistikave monetare dhe financiare janë: BQK dhe bankat komerciale (Raporti Bankar Statistikor dhe Raporti mbi Normat e Kamatës).

9. Periodiciteti

Statistikat e korporatave depozituese (BQK-së dhe bankave komerciale) kanë filluar të përpilohen dhe publikohen që nga viti 2001, në baza mujore. Ndërsa statistikat mbi korporatat tjera financiare kanë filluar të përpilohen dhe publikohen që nga viti 2004 në baza tremujore.